



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR

Shqyrtimi i shtatë i tarifës së energjisë elektrike

SHTE7 (2013-2016)

Detajet për KEK Gjenerimin

22 mars 2013

Përmbajtja

1	Hyrje	1
2	Vlerësimi përfundimtar i kostos së supozuar të furnizimit me linjit.....	1
2.1	Propozimet e shpenzimeve kapitale të divizionit të KEK-ut të Mihjes	2
2.2	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve kapitale të Divizionit të Mihjes.....	3
2.2.1	Pajisjet ndihmëse	3
2.2.2	Kostoja e shpronësimit – Fshati Hade	3
2.2.3	Stacionet kthyese	4
2.2.4	Renovimi i makinave të kombinuara A&B TC – B	4
2.2.5	Makineritë e rënda.....	4
2.2.6	Riparimi i dy ekskavatorëve.....	4
2.2.7	Shiritat e dyfishtë transportues për Sibovcin jugperëndimor	5
2.2.8	Shpenzimet tjera kapitale.....	5
2.2.9	Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve kapitale të Divizionit të Mihjes.....	5
2.3	Propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të Mihjes	6
2.4	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së lidhur me propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të mihjes së KEK-ut.....	6
2.4.1	Rialokimi i kostos së zyrës kryesore	6
2.4.2	Niveli i stafit.....	6
2.4.3	Pagat dhe kostot e ndërlidhura	6
2.4.4	Riparimet dhe mirëmbajtja	7
2.4.5	Energjia elektrike dhe shpenzimet tjera të komunale	7
2.4.6	Shpenzimet tjera operative	8
2.4.7	Transporti	8
2.4.8	Kostot e sigurimit	8
2.4.9	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së mbi propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të Mihjeve të KEK-ut	8
2.4.10	Kthimi i supozuar i Kapitalit	9
3	Vlerësimi përfundimtar i Prodhimit të rregulluar të KEK-ut	9

3.1	Kosova A – Capex-i i propozuar	9
3.1.1	Remonti kapital Njësia A3	10
3.1.2	Transporti hidraulik i hirit Kosova A	11
3.1.3	TCA - 2620 metra (përfshirë 4 porta të larta rrethuese)	11
3.1.4	Kamerat vëzhguese	11
3.1.5	Kamioni i ri zjarrfikës për Prodhimin	11
3.1.6	Renovimi kapital i Njësive A4 dhe A5	11
3.1.7	Renovimi i Njësive A3, A4	12
3.1.8	Renovimi i njësive A3, A4, A5	12
3.1.9	Pompa e reja për furnizim të bojlerit me shpejtësi të ndryshueshme, Njësia A3, A4	12
3.1.10	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet kapitale për “TC Kosova A”	12
3.2	Shpenzimet operative të propozuara – “TC Kosova A”	13
3.2.1	Rialokimi i kostove të administratës qendërore	13
3.2.2	Kostot e stafit	13
3.2.3	Kostot e karburantit dhe shërbimet tjera publike	13
3.2.4	Kostot e mirëmbajtjes	13
3.2.5	Kostot e materialeve dhe furnizimeve	14
3.2.6	Shpenzimet tjera operative	14
3.2.7	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimet operative të KEK-ut për TC Kosova A	14
3.3	Kosova B – Capex-i i Propozuar	15
3.3.1	TCB - 2550 Rrethimi (Përfshirë 4 portat rrethuese të larta)	16
3.3.2	Kamerat e vëzhgimit	16
3.3.3	Kamioni i ri zjarrfikës për Gjenerim	16
3.3.4	Hapja e bombolave të presionit të lartë dhe të tjera	16
3.3.5	Kapsula mbështjellëse e re për Turbinën me Presion të Lartë, Njësia B1	17
3.3.6	Rinovimi Kapital, Njësia B1	17
3.3.7	Vlerësimi përfundimtar i Capex-it nga ZRRE për Kosovën B	17
3.4	Opex i Propozuar i “TC Kosova B”	17
3.4.1	Rialokimi i kostove të administratës qendërore	17
3.4.2	Kostot e stafit	17

3.4.3	Kostot e karburantir dhe shërbimet tjera	18
3.4.4	Kostot e mirëmbajtjes	18
3.4.5	Shpenzimet tjera operative	18
3.4.6	Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për Shpenzimet operative të “TC Kosova B”	19
4	Parametrat tjera rregullativë	19
4.1	Faktori i efikasitetit.....	19
4.2	Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK)	19
5	MAR përfundimtarë 2013-2016	20

1 Hyrje

Në një letër të datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja paralajmëroi fillimin e Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike 7 (SHTE7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarve për periudhë shumë vjeçare. Këto të ardhura maksimale të lejuara do të duhej, me ligj, të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara.

Në harmoni me Rregullat e publikuara të përcaktimit të çmimeve, ZRRE ka vlerësuar me kujdes kostot e parapara të të licencuarve. KEK gjenerimit i është kërkuar që t'i prezantojë parashtresën e vet ZRRE-së dhe opinionit publik më 3 shtator. Që nga kjo datë, ZRRE ka punuar për së afërmi me kompaninë për të qartësuar parashtresat fillestare. KEK-u që atëherë ka parashtruar të dhëna dhe arsyetime domethënëse shtesë.

Është gjithashtu me rëndësi të ceket se, edhe pse ZRRE nuk rregullon Divizionin e Mihjeve në KEK, ai duhet të përcaktojë një vlerë për koston e thëngjillit, e cila përbën një pjesë të koston së prodhimit të energjisë elektrike. Në të ardhmen, mund të ndodh që çmimi i thëngjillit të përcaktohet nga një marrëveshje për furnizim të linjtit, por aktualisht nuk ka ndonjë marrëveshje e tillë e cila është në fuqi. Në mënyrë që të shqyrtohen çmimet ekzistuese të të thëngjillit, të cilat ngarkohen nga divizionet e KEK-ut për mihje dhe prodhim, ZRRE iu ka kërkuar inxhinierëve konsultues të EIHP-së që të shqyrtojnë çmimin e prodhimit të thëngjillit nga divizioni për mihje, si dhe koston e prodhimit. ZRRE ka marrë parasysh raportin e tyre në Vlerësimin përfundimtar.

Dokumenti është pjesë përbërëse e Vlerësimit përfundimtar dhe duhet të lexohet në përputhje me “Vlerësimin përfundimtar – Pasqyrë” të botuar në të njëjtën kohë me këtë dokument dhe me anekset e tij. Është i strukturuar si në vijim:

Pjesa 2 – Vlerësimi përfundimtar i Kostos së supozuar të furnizimit me linjit

Pjesa 3 – Vlerësimi përfundimtar i Prodhimit të rregulluar të KEK-Gjenerimit

Pjesa 4 – Parametrat e tjerë rregullativ

Pjesa 5 – MAR-et përfundimtare 2013-2016

2 Vlerësimi përfundimtar i koston së supozuar të furnizimit me linjit

Rregulli i ZRRE-ës për përcaktim të çmimeve të prodhimit thotë që, në mungesë të një marrëveshjeje për furnizim të linjtit, ZRRE duhet të përcaktojë një kosto të furnizimit të linjtit për gjeneratorët e rregulluar, Kosova A dhe Kosova B. Rregulli më tej deklaron që kostoja e furnizuar e linjtit “llogaritet në të njëjtën mënyrë si kostot tjera të arsyeshme të gjenerimit të rregulluar, ku përfshihen amortizimi i supozuar, kthimi i supozuar i kapitalit,

dhe kostot e mirëmbajtjes.” Në këtë pjesë, ZRRE-ja komenton mbi vlerësimin e saj lidhur me kostot e deklaruara operative dhe kapitale të biznesit të mihjes së KEK-ut.

2.1 Propozimet e shpenzimeve kapitale të divizionit të KEK-ut të Mihjes

Më 19 tetor 2012, ZRRE-ja ka lëshuar një raport konsultimi (“Konsultimi i tetorit”) ku është përvijuar kuptimi i parashtresës së KEK-ut deri në atë moment dhe me të cilin kërkohen qartësime dhe arsytetime shtesë. Në veçanti, ZRRE-ja i ka kërkuar KEK-ut që t’i shpjegojë projektet kapitale të përshkruara në parashtresën e vet të gushtit. Në përgjigje të Vlerësimi të përkohshëm të ZRRE-së të 8 janarit, Divizionit i Gjenerimit të KEK-ut ka parashtuar materiale shtesë, i cili ishte shqyrtuar dhe qartësuar në takimet me të licencuarit në fillim të shkurtit. Projektet kapitale të planifikuara në këtë periudhë gjithashtu përshkruhen në raportin e vlerësimit teknik të përgatitur nga konsulentete e ZRRE-së, (Instituti energjetik Hrvoje Požar (EIHP)).

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën e ardhshme të kontrollit, 2013 – 2016, parashtresa fillestare e KEK-ut përmbante një numër të projekteve për vitin 2012. KEK-u tash ka ofruar shpenzimet përfundimtare për vitin 2012, të cilat kapin shumë prej rreth [6 milion më pak] sesa është kërkuar fillimisht. ZRRE-ja është e kënaqur se këto projekte janë të domosdoshme dhe aprovon rikthimin e kostove aktuale, ashtu siç janë zbërthyer në tabelën në vijim:

Tabela a – Projektet kapitale të Divizionit të mihjes që janë realizuar në vitin 2012

Projektet kapitale të propozuara të KEK-ut për Divizionin e Mihjes	2012 €000s
Bartja e kontratave të vitit 2011 nga huatë	
Pajisjet ndihmëse*	
Kostoja e zhvendosjes – Fshati Hade*	
Gjithsej projektet kapitale të bartura nga viti 2012	22,049

ZRRE mbetet e mendimit se këto shpenzime është dashur të jenë planifikuara si duhet në kuadër të SHTE6.

Tabela b në faqen tjetër tregon shpenzimet kapitale të planifikuara nga Divizioni i Mihjes për periudhën e re të kontrollit, 2013-2016:

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

Tabela b – Projektet kapitale të propozuar nga Divizioni i Mihjes –KEK 2013-2016

Projektet e propozuara nga KEK-u 2013-2016	2013 €000s	2014 €000s	2015 €000s	2016 €000s	Total €000s
Kostoja e zhvendosjes – Fshati Hade*					
Stacionet kthyese					
Renovimet e makinave të kombinuara A&B					
Makineria e rëndë					
Riparimi i dy ekskavatorëve / 2 ekskavatorëve kompakt					
Ndërtesa e garderobave					
Shiritat e dyfishtë të transportit					
Sistemi i kontrollit nga larg					
Shpenzimi total i kërkuar kapital (të gjitha vitet)	17,827	63,500	62,000	19,000	162,327

2.2 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve kapitale të Divizionit të Mihjes

Tabela 7 e raportit të EIHP-së në Aneksin 1 tregon projektet kapitale të propozuara nga Divizioni i Mihjes . EIHP ka shqyrtuar nivelet e propozuara të shpenzimeve kapitale dhe ka rekomanduar që ZRRE të beje disa ulje të kostove.

2.2.1 Pajisjet ndihmëse

KEK-u ka siguruar një numër të artikujve kapital sipas këtij zëri buxhetor për të modernizuar stoqet e pajisjeve ndihmëse, përfshirë buldozerë, kamionë, hedhës, ekskavatorë, ngarkues, pirunerë, minibusë dhe Land Rovera. Ky investim prej rreth 3 milionëve tashmë është bërë ndërsa pajisjet gjegjëse janë vënë në përdorim.

2.2.2 Kostoja e shpronësimit – Fshati Hade

Zhvendosja e banorëve nga Fshati Hade nevojitet për të mundësuar zgjerimin e domosdoshëm të minierës. Kostoja e zhvendosjes është vlerësuar të jetë €8 milionë, kosto kjo e cila efektivisht është jashtë kontrollit të KEK-ut, dhe bazohet mbi dokumentin e hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. KEK-u tashmë ka ofruar kosto përfundimtare të realizuara për këtë projekte prej rreth €6 milionëve, ndërsa rreth 2 milionë do të realizohen në vitin e ardhshëm. Prandaj ZRRE-ja do ta merr këtë shifër më të ulët në konsideratë në llogaritjet e tyre përfundimtare.

2.2.3 Stacionet kthyese

Këto janë stacione kthyese të cilat duhet të montohen në shiritin transportues të thëngjillit në Sibovcin jugperëndimor është i domosdoshëm dhe i arsyeshëm dhe ZRRE-ja e ka lejuar këte investim.

2.2.4 Renovimi i makinave të kombinuara A&B TC – B

KEK-u ka deklaruar që është e nevojshme të riparohen këto makina për të siguruar furnizimin e thëngjillit për stacionin e “Kosova B”. Për të arsyetuar këtë kosto, KEK-u nuk ka ofruar detaje të mjaftueshme, por pas Vlerësimit të përkohshëm të ZRRE-së, KEK-u ka ofruar arsyetim domethënës dhe ZRRE-ja tash është pajtuar se shpenzimi është i domosdoshëm për sigurinë e furnizimit. Edhe pse fillimisht KEK-u kishte kërkuar një shumë më të madhe se ajo e lejuar nga ZRRE-ja prej rreth €2 milionëve. ZRRE-ja ka lejuar vlerën të cilën kompanit e kanë ofruar në tenderin e fundi të anuluar për këtë projekt.

2.2.5 Makineritë e rënda

KEK-u propozon zëvendësimin e makinave dhe pajisjeve të rënda të vjetërsuara. Sërish, edhe këtu KEK-u ka ofruar detaje të pamjaftueshme për të arsyetuar koston, por pas Vlerësimit të përkohshëm të ZRRE-së, KEK-u ka ofruar informata shtesë lidhur me investimin. KEK-u ka ofruar një listë të makinave të rënda të cilat synon t'i sigurojë së bashku me kostot për njësi, të cilat janë bazuar mbi kontrata paraprake. Bazuar mbi këtë informatë, ZRRE-ja aprovon investimin në vlerë më të vogël se sa ajo e kërkuar prej €8.5 milionëve.

2.2.6 Riparimi i dy ekskavatorëve

KEK beson se nevojiten dy ekskavatorë kompakt dhe shirita vetë-shtytëse të transportit për minierën e Sibovcit për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm të thëngjillit në stacionet Kosova A dhe B. Mirëpo, KEK-u ka njoftuar ZRRE-në dhe konsulentët se ofertat e pranuar nga KEK-u në fakt ishin rreth €15 milionë nën shumën fillimisht të kërkuar nga Kompania. Prandaj ZRRE propozon lejimin e kësaj blerjeje kapitale në përputhje me ofertat e pranuar. KEK-u mbetet pranë qëndrimit se vlera e kërkuar është reale. Mirëpo, vlerat e realizimit të KEK-ut kanë një tendencë të vazhdueshëm të paraqitjes nën shumën e parashikuara, prandaj ZRRE nuk propozon që të zhvendoset nga Vlerësimi i saj i Përkohshëm. Nëse kostoja reale e tejkalon vlerën e lejuar nga ZRRE atëherë, në përputhje me Rregullen për përcaktimin e çmimit, ZRRE-ja do të rregullojë vlerën në rishqyrtimin periodik të radhës, me kusht që KEK-u të ofrojë dëshmi të dokumentuar të çmimeve të kontratave.

2.2.7 Shiritat e dyfishtë transportues për Sibovcin jugperëndimor

KEK-u beson se për minierën e Sibovcit nevojiten dy shirita të rinj transportues në mënyrë që të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm me thëngjill në stacionet Kosova A dhe B. KEK-u ka ofruar detajet të pamjaftueshme për të arsyetuar koston por pas Vlerësimit të përkohshëm të ZRRE-së, KEK-u ka ofruar arsytetime domethënëse dhe shpenzimi është i domosdoshëm për sigurinë e furnizimit. Mirëpo, takimet me Divizionin e Mihjes kanë shpalosur që, edhe pse të domosdoshme, ekziston një pasiguri mjaft e madhe lidhur me koston në të ardhmen, si dhe financimit të saj (financimi nga donatori apo kompania). Si rrjedhojë, ka një shkallë pasigurie edhe me datat për implementim. Prandaj, ZRRE e aprovon këtë projekt parimisht dhe do të përfshijë një lejim të menjëhershëm prej 50% për këtë projekt në TSHV-në në 2014. Duke pasur parasysh pasigurinë rreth orarit, ZRRE-ja ka përdorur të njëjtin profil të shpenzimeve si atë të sugjeruar nga KEK-u.

2.2.8 Shpenzimet tjera kapitale

KEK-u ka planifikuar tre projekte të tjera kapitale për periudhën e kontrollit: një ndërtesë të re për gardërobë dhe një sistem të kontrollit nga larg. ZRRE konsideron se këto dy projekte janë arsyetuar në masë të duhur dhe se kostot e propozuara janë të arsyeshme, prandaj propozon që këto të lejohen në tërësi.

2.2.9 Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve kapitale të Divizionit të Mihjes

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për kostot kapitale të mihjes, të cilat janë pjesë e koston së supozuar të furnizimit me linjit, të cilat duhet të financohen përmes MAR-it të prodhimit, janë dhënë në tabelën c në vijim.

Tabela c – Shpenzimet kapitale të Divizionit të Mihjes

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimeve kapitale të Mihjes (me përjashtim të granteve)	2012 € 000's	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej € 000's
Capex-i i propozuar nga KEK-u (i ndryshuar)	22,094	17,827	63,500	62,000	19,000	184,421
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së	22,094	14,509	39,955	41,455	9,955	127,966
Dallimi (€ 000's)	0	-3,318	-23,545	-20,545	-9,045	-56,455
Dallimi (%)	0%	-19%	-37%	-33%	-48%	-31%

Duhet të ceket që duke bere këtë Vlerësim, ZRRE synon të sigurojë që KEK-u të ketë financim të mjaftueshëm për të kryer investime thelbësore kapitale në Mihje, pasi që pa këto, paraqitet rrezik për veprimtarinë e vazhdueshme të dy termocentraleve të thëngjillit të Kosovës. Çfarëdo ndërprerjeje në furnizim të mihjes do të ketë efekt të dëmshëm për furnizimin e konsumatorëve. ZRRE-ja vlerëson që projektet e propozuara janë thelbësore për të arritur sigurinë e furnizimit. Mirëpo, ekziston një pasiguri domethënëse lidhur me disa kosto, si dhe me burimin e financimit të tyre. Të ballafaquar me një pasiguri të tillë, ZRRE jep pëlqimin për projekte, por jep lejim të

pjesërishëm vetëm në dy raste. KEK-ut i kërkohet të vazhdojë planifikimin dhe përgatitjet dhe, pasi të ketë hartuar projekt propozim definitiv, përfshirë edhe mënyrën e financimit, të parashtrijë detajet tek ZRRE. Pas vlersimeve nga ZRRE-ja do të bëhen ndryshimet gjegjëse.

2.3 Propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të Mihjes

Në parashtrirat e veta, KEK-u ka dhënë kosto të propozuara operative qendrore apo të zyrës qendrore, të cilat ZRRE do t'i alokojë në të gjitha bizneset e licencuara.

Disa kosto të parashtruara janë të pakontrollueshme, siç janë tatimet. Të tjerët janë të kontrollueshme. ZRRE ka shqyrtuar parashikimet e KEK-ut për kostot e kontrollueshme me mbështetjen e inxhinierëve konsultues. Në rast të kostove vijuese, ZRRE mendon se KEK-u nuk i ka arsyetuar në tërësi nivelet e kostove të parashikuara.

2.4 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së lidhur me propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të mihjes së KEK-ut

2.4.1 Rialokimi i kostos së zyrës kryesore

Në parashtrirën e vet KEK-u ka prezantuar kostot e veta operative në disa zëra: kostot e pagave, të energjisë elektrike dhe komunale të tjera, mirëmbajtja, materialet dhe furnizimet, shpenzimet për çështjet mjedisore, shpenzimet e tjera operative dhe shpenzimet e brendshme. Ai i ka alokuar këto kosto jo vetëm për veprimtari të licencuara por edhe për zyrën qendrore të KEK-ut. Mirëpo, nga këndvështrimi rregullativ, të gjitha këto kosto duhet t'iu alokohen veprimtarive të licencuara në mënyrë që të mund të kthehen përmes një MAR-i adekuat. Prandaj ZRRE i ka ndryshuar kostot e parashtruara. Në aplikimin e këtij ndryshimi, ZRRE ka zbatuar mënyrën e KEK-ut për ndarjen e kostove në vitin 2012, dhe këto i ka zbatuar tutje. Vlerësimi në vijim bazohet në kosto të ndryshuara.

2.4.2 Niveli i stafit

KEK-u ka deklaruar që niveli i vet i stafit në mihje do të ulet prej 3,177 në vitin 2012 në 2,891 deri në fund të vitit 2017. Kjo në masë të madhe shkaktohet nga pensionimet.

ZRRE mendon se këto nivele të stafit mund të ulen më tej dhe se biznesi do të duhej të ishte në gjendje të përmirësojë produktivitetin e tij. Në përcaktimin e Faktorit të Efikasitetit për KEK Prodhimin, synon të stimulojë kompaninë të kërkojë përmirësimet në produktivitet.

2.4.3 Pagat dhe kostot e ndërlidhura

KEK-u ka propozuar një rritjes reale vjetore të pagave prej 5% në tërë kompaninë, mbi nivelin e inflacionit. ZRRE nuk sheh justifikim për rritje të tillë reale, posaçërisht

në nivelet më të ulëta të produktivitetit të dëshmuara nga KEK-u. Është përgjegjësi e menaxhmentit të KEK-ut që të përcaktojë nivelin e pagës, por duhet të gjejë kursimet gjetiu në afarizmin e vet, pa preku performancën. Prandaj, ZRRE propozon që kostoja e pagës për Divizionin e Mihjes së KEK-ut të mbetet në nivelin e vitit 2012 në përcaktimin e kostos së supozuar të linjtit.

2.4.4 Riparimet dhe mirëmbajtja

Kostot historike të riparimit dhe të mirëmbajtjes të KEK-ut nuk kanë treguar ndonjë tendencë të rregullt, ndërsa nivelet e parashikimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit janë gjithashtu variabile. KEK-u nuk ka ofruar asnjë arsytim të qartë për shumën e parashikuara. Duke marrë parasysh këto pasiguri, ZRRE-ja ka propozuar që të përcaktojë lejimin e mirëmbajtjes së parashikuar në nivelin e kostos mesatare prej €1033 / 000t thëngjill.

2.4.5 Energjia elektrike dhe shpenzimet tjera të komunale

Sa i përket kostos për energji elektrike dhe shpenzimet tjera të komunale, KEK-u ka raportuar kosto në dy kategori: kosto të karburantit, gazit dhe ujit. Këto kosto janë si shtesë e veprimtarisë së mihjes, ndërsa shumën vjetore të akumuluar mund të pritët të varirojnë së bashku me sasinë e thëngjillit të mihur. Mirëpo, kostoja për njësi e këtyre shërbimeve për 000t të thëngjillit pritët të mbetet konstant gjatë kësaj periudhe.

Parashtesa e KEK-ut përkitazi me karburantin ka shënuar kosto në rritje, të cilat Kompania i ka shpjeguar si rezultat i kostos së karburantit në rritje për njësi, duke parashikuar një rritje prej 12% nga €321/000t thëngjill në vitin 2012 në €363/000t thëngjill në vitin 2013, dhe pastaj një rritje në madhësi të ndryshme në kostot për njësi deri në vitin 2016. KEK-u nuk ka ofruar ndonjë argument të qartë për të mbështetur këtë rritje në kostot e njësisë në vitin 2013, dhe as të mbështesë modelin variabil të së ardhmes të lëvizjeve në çmimet e karburantit. Prandaj, ZRRE ka ruajtur vlerën e vitit 2012 prej €321/000t thëngjill për periudhën e kontrollimit, duke pranuar që, si tek shpenzimet tjera, këto do të ndryshohen gjatë tërë periudhës kontrolluese në mënyrë që të marrin parasysh inflacionin aktual. Me këtë ulen kostot e parashikuara të KEK-ut për karburant për €2.4 milionë për periudhën 2013-2016.

Kostot e propozuara të KEK-ut për njësi, për gaz dhe ujë parashikohet të jenë në paushall prej €24.10/000t thëngjill gjatë periudhës së ardhshme rregullative(2013-16), të cilat janë pak më të larta se kostot e raportuara historike, edhe pse vlerat historike të raportuara kanë treguar luhajtje të papritura. ZRRE pret që këto kosto për njësi të mbeten mjaft stabile, ndërsa kostoja mund të lëvizë varësisht prej sasisë së prodhuar të thëngjillit. ZRRE supozon një vlerë prej €24/000t thëngjill, që është një

vlerë mesatare për periudhën 2008-2011. Rezultati është një ulje e paktë e kostos së aprovuar për gaz dhe ujë prej €3000 për periudhën rregullative 2013-2016.

2.4.6 Shpenzimet tjera operative

Nën “shpenzimet tjera operative” KEK-u ka paraparë kosto totale prej €139,775 milionë në periudhën 2013-2016. Nga kjo shumë, €103,152 ose 74% përfaqëson taksë të pakontrollueshme për shfrytëzim të linjitet, të cilën KEK-u duhet t’ia paguajë Qeverisë. 26% i mbetur përbëhet nga transporti i personelit për dhe nga miniera, sigurimi, kostot e zhvendosjes së zyrës kryesore, licencat dhe “të tjera”. Kategoria “të tjera” përfaqëson koston për derivate, dizell, benzinë dhe kimikale e gaz, të cilat përbëjnë një kosto të konsiderueshme prej €10,424,000 gjatë periudhës 2013 deri 2016.

2.4.7 Transporti

KEK-u ka paraparë një kosto gjithnjë në rritje të shërbimeve të transportit, të cilat përfaqësojnë koston e lëvizjes së personelit rreth minierës, si dhe bartjen e tyre prej dhe në vet minierë. Parashikimet e KEK-ut tregojnë një rritje reale të shërbimeve të transportit prej rreth 22%, në periudhën ndërmjet 2013 dhe 2016 në kohën kur numri i stafit është duke u zvogëluar. KEK-u nuk ka ofruar ndonjë arsyetim për këtë rritje, dhe ZRRE konstaton se do të ishte më e qëlluar të supozohet një rritje zero nga vlera prej €115,000 e parashtruar për vitin 2013.

2.4.8 Kostot e sigurimit

KEK-u i ka paraparë kostot vjetore të sigurimit në të njëjtën shumë si vitin e kaluar. Duke pasur parasysh shtirjen fizike të minierave, ZRRE nuk e sheh këtë shumë si të paarsyeshme dhe propozon që të lejohet në tërësi, si pjesë e kostos së supozuar të furnizimit me linjit.

2.4.9 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së mbi propozimet e shpenzimeve operative të Divizionit të Mihjeve të KEK-ut

Tabela në vijim përmbledh shpenzimet e përgjithshme operative të Mihjes, të propozuara nga KEK-u për periudhën 2013 deri 2016, së bashku me vlerësimin e propozuar të ZRRE-së për të njëjta ato shpenzime, për qëllime të llogaritjes të kostos së supozuar për prodhim të rregulluar. Duhet të ceket që tabela në vijim përfshin efikasitetin, ndërsa përjashton zhvlerësimin dhe taksën për shfrytëzim të linjitet, të cilat përfaqësojnë kosto mjaft të mëdha të pa-kontrollueshme operative në mënyrë që të fitohet një pasqyrë më e vërtetë e shpenzimeve operative të Mihjes.

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

Tabela d – Shpenzimet operative Divizioni i Mihjes

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet operative të Mihjes	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej 2013-2016 € 000's
Shpenzimet e propozuara operative të KEK-ut	46,115	47,540	48,653	49,237	191,545
Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së	40,533	38,691	36,633	34,764	150,621
Dallimi (€ 000's)	-3,821	-5,476	-7,120	-8,124	-24,541
Dallimi (%)	-8%	-12%	-15%	-17%	-13%

2.4.10 Kthimi i supozuar i Kapitalit

Në llogaritjen e kostos së supozuar për furnizimin e linjitet, ZRRE duhet të bëjë një supozim lidhur me kthimin e duhur të kapitalit për veprimtarinë e mihjes.

ZRRE ka përcaktuar Koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) për Mihjen bazuar në vlerësimet paraprake të Kthimit të kërkuar në Ekuitet, koston reale të financimit të borxhit dhe nivelin aktual të gearing (norma borxh/ekuite që i nënshtrohet kufizimeve të gearing të dhënë në diskutimet paraprake të ZRRE-së për WACC).

ZRRE fillimisht ka supozuar një kthim komercial në ekuitet për të gjitha kompanitë e rregulluara në sektor. ZRRE gjithashtu ka kërkuar udhëzim nga qeveria lidhur me nivelin e kthimit në ekuitet, të cilin qeveria mund ta kërkojë si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria ka bërë me dije se ata do të shqyrtojnë një kthim më të ulët për operatorët në pronësi publike, krahasuar me kthimin i cili mund të pritët nga një pronar privat. Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së është që një nivel prej 5.5% të kthimit në ekuitet pas tatimeve do të ishte i qëlluar për kompanitë publike. Prandaj ZRRE e ka zbatuar këtë kthim në ekuitet gjatë vlerësimit të WACC të Divizioni të Mihjes. Kjo nuk ndryshon nga vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së.

MPKK për Mihje përcaktohet në 4.66% (real, para tatimit).

3 Vlerësimi përfundimtar i Gjenerimit - KEK

3.1 Kosova A – Capex-i i propozuar

Projektet kapitale të planifikuara për Kosova A në periudhë përshkruhen në Shtojcën A, së bashku me vlerësimin teknik të arsytimit të KEK-ut për projektet.

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën e ardhshme të kontrollit, 2013–2016, parashtrëta e KEK-ut përmbante një numër të projekteve për vitin 2012. KEK-u tash ka ofruar informata për t'i arsytuar këto si projekte të domosdoshme, edhe pse ZRRE vë në

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

pah se këto kosto janë arsyetuar si pjesë e procesit të SHTE6. ZRRE-së do t'i nevojiten më shumë informata nga KEK-u, për t'u bind që nuk ka numërim të dyfishtë ndërmjet leimit nga SHTE6 dhe këtyre propozimeve për MAR-in e vitit 2013–2016. Aktualisht, ZRRE i ka përfshirë këto në llogaritjen e re të MAR-it. Këto projekte të vitit 2012 për Kosova A janë zbërthyer sipas zërave në tabelën në vijim.

Tabela e – Projekte kapital të Kosova A të cilat janë realizuar

Projektet e propozuara kapitale të KEK-ut për Prodhim Kosova A (Ndryshuar në shkurt 2013)	2012 €000s
Remonti kapital i Njesisë A3	
Transportuesi hidraulik i hirit	
Precipitator elektrostatik A5	
Precipitator elektrostatik A3	
Njësia e transformatorit A3	
Gjithsej projektet e bartura kapitale të vitit 2012	36,480

Përveç kësaj, *Tabela f* në vijim tregon projektet kapitale për TC Kosova A të planifikuara nga Divizioni i Prodhimit të KEK-ut për periudhën 2013-2016:

Tabela f – Projektet e propozuara kapitale për Kosova A 2013-2016

Projektet për 2013-2016	2013 €000s	2014 €000s	2015 €000s	2016 €000s	Gjithsej €000s
Pajisjet për monitorim të mjedisit për njësitin A					
Kompresorët e ajrit - TCA					
Orëmatësit TCA-2620 & dhe portat e larta rrethuese					
Kamerat vëzhguese					
Kamioni i ri për zjarrfikës					
Renovimi kapital i njesisë A4					
Filtër të rinj elektrostatik Njësia A4					
Kompresorë të ajrit - TCA					
Pompa për furnizim të ujit Njësia A3					
Pompa për furnizim të ujit Njësia A4					
Instalimi i ftohësve të ujit Njësitë A3, A4, A5					
Remonti kapital i Njesisë A5					
Renovimi vjetor i njësive A3 dhe A4					
Renovimi vjetor i njësive A3, A4, A5					
Renovimi vjetor i njësive A3, A4, A5					
Projektet e shpenzimeve kapitale 2013-2016	26,797	19,530	12,750	10,000	66,040

3.1.1 Remonti kapital Njësia A3

Kostoja e remontit kapital të Njesisë A3 të planifikuara për vitin 2012 fillimisht ishte dhënë me një vlerësim shumë të ulët. KEK-u tash ka kontraktuar kompani të ndryshme për të tenderuar

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

për punë të ndryshme të domosdoshme. Çmimet reale të pranuar nga KEK-u janë mbi vlerësimet fillestare të pranuar.

Sipas informatave të pranuar nga KEK-u, remonti kapital është kryer në fund të vitit 2012. (Punët përfshijnë riparime në turbinën me avull, gjenerator elektrik dhe bojler).

3.1.2 Transporti hidraulik i hirit Kosova A

Sistemi i ri hidraulik për transport të hirit për Kosova A është i domosdoshëm për të ndaluar praktikën e transportimit të hirit në shirit të hapur në pìrgun e hirit i cili nuk është i mbuluar. Do të kontribuojë thelbësisht lehtësimit të problemeve të emetimit të hirit në komunitetet fqinje. Sistemi i ri do të lejojë që hiri të përzihet me ujin dhe të transportohet me gyp në pjesën e harxhuar të minierës.

Projekti i njëjtë është përfunduar për Kosova B. Kostoja e pritur e investimit është vlersuar si e arsyeshme.

3.1.3 TCA - 2620 metra (përfshirë 4 porta të larta rrethuese)

KEK-u ka propozuar ngritjen e rrethojës, e cila është e domosdoshme që të ndajë dhe të mbrojë patundshmërinë e Termocentralit Kosova A nga divizionet fqinje të Thëngjillit. KEK-u ka ofruar detaje të specifikacionit dhe arsyetimit për këtë kosto. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon lejimin e kësaj kostoje në tërësi.

3.1.4 Kamerat vëzhguese

KEK-u propozon instalimin e kamerave të sigurisë me synim monitorimin e impiantit të Kosova A, të cilat duhet të instalohen në intervale prej 60m në rrethojat e reja të sigurimit. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon lejimin e kësaj kostoje në përgjithësi.

3.1.5 Kamioni i ri zjarrfikës për Prodhimin

KEK-u synon të blejë një kamion të ri zjarrfikës me shkallë prej 40m, pasi që pasisjet ekzistuese nuk mund të arrijnë lartësinë e duhur. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që të lejojë këtë shpenzim në tërësi.

3.1.6 Renovimi kapital i Njesisë A4 dhe A5

KEK-u duhet të ndërmerremontin kapital të Njesisë A4 në vitin 2013, dhe të Njesisë A5 në vitin 2014, për shkak se janë arritur orët maksimale të punës në këtë Njësi. KEK-u do të fillojë kryerjen e punëve si në turbo-gjeneratorin ashtu edhe në bojler si pjesë e pakos. EIHP rekomandojnë që KEK-u të mbetet në parashikimet fillestare të kostove.

ZRRE është e kënaqur se këto remonte do të sjellin dobi të sigurisë dhe funksionalitet më të madh të pajisjes, efikasitet dhe disponueshmëri të rritur, si dhe sigurinë e rritur të stafit dhe ZRRE-ja propozon të lejojë një total për dy njësitë.

3.1.7 Renovimi i Njësive A3, A4

KEK-u planifikon të kryejë riparime kapitale të Njësive A3 dhe A4 në vitin 2014 gjatë ndërprerjeve vjetore të njësive në mënyrë që të ruajnë performancën dhe stabilitetin operativ. ZRRE e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon që ta lejojë këtë kosto në tërësi.

3.1.8 Renovimi i njësive A3, A4, A5

Gjatë ndërprerjeve vjetore të vitit 2015 dhe 2016, KEK planifikon gjithashtu të kryejë riparime dhe renovime kapitale në të tre njësitë punuese të Kosovës A. ZRRE pranon arsyetimin për kryerjen e këtyre punëve vjetore, por nuk sheh arsyetim për një rritje reale të koston për njësi. Prandaj, ZRRE propozon të lejojë një kosto prej €2.5 milionë më pak se shuma e kërkuar nga KEK-u për të tre njësitë në secilin prej viteve 2015 dhe 2016.

3.1.9 Pompa e reja për furnizim të bojlerit me shpejtësi të ndryshueshme, Njësia A3, A4

KEK-u ka këshilluar që pompat furnizuese, të cilat shërbejnë bojlerët në Njësinë A3 dhe A4 kërkojnë zëvendësim me pompa furnizuese me shpejtësi variable. KEK-u ka vlerësuar një kosto më të lartë për këtë blerje kapitale. Mirëpo, gjatë diskutimeve me KEK-un, është e qartë se ky zë buxhetor më herët ishte siguruar me një kosto më të ulët, prandaj ZRRE propozon të zvogloj vlerën e kërkuar për të dy njësitë për 80 000 euro.

3.1.10 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet kapitale për “TC Kosova A”

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet kapitale të “Kosova A” është dhënë në tabelat g në vijim.

Tabela g – Vlerësimi përfundimtar i projekteve kapitale i Kosova A

Vlerësimi përfundimtar i shpenzimeve kapitale për TC Kosova A	2012 € 000's	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej € 000's
Sh. Kapitale të kërkuar nga KEK-u	36,480	26,797	19,530	12,750	10,000	105,557
Sh. Kapitale të lejuara nga ZRRE	36,480	23,018	17,710	10,210	7,500	94,918
Dallimi (€ 000's)	0	-3,780	-1,820	-2,540	-2,500	-10,640
Dallimi %	0%	-14%	-9%	-20%	-25%	-10%

3.2 Shpenzimet operative të propozuara – “TC Kosova A”

3.2.1 Rialokimi i kostove të administratës qendërore

ZRRE ka rialokuar kosto të administratës qendërore për “TC Kosova A” në të njëjtën mënyrë si është përshkruar në Divizionin e Mihjes në pjesën 2.2.1 më lartë.

3.2.2 Kostot e stafit

Në llogaritjet e veta, KEK-u ka supozuar një rritje prej 5% në kosto e stafit për Kosova A mbi koston e supozuar të inflacionit. ZRRE nuk sheh ndonjë arsytim për këtë rritje të koston reale të stafit. Prandaj, propozonë që lejimi i koston për paga të mbetet në nivelet e vitit 2012 për periudhën e ardhëshme rregullative..

3.2.3 Kostot e karburantit dhe shërbimet tjera publike

Shpenzimi i paraparë KEK-ut prej rreth €25.8 milionëve për periudhën 2013-2016 për “Kostot e karburantit dhe shërbimet e tjera publike” për Kosova A, një zë i koston i cili përbëhet prej: koston së karburantit (pa përfshirë koston e thëngjillit), kostoja e derivateve (lubrifikantëve) dhe kemikalieve të tjera.

Kostoja e karburantit, e cila i referohet koston së mazutit, është marrë si një shumëfish i koston së mazutit të parashikuar për njësi dhe sasisë së pritur të mazutit që do të përdoret. ZRRE ka shqyrtuar supozimin prapa këtyre vlerave dhe mendon se ato janë të arsyeshme. Prandaj, ZRRE propozon që të këto shuma të lejohen.

3.2.4 Kostot e mirëmbajtjes

Kategoria e mirëmbajtjes përbëhet nga zëra të shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes. Për periudhën rregullatore të vrojtuar, shërbimet e riparimit nuk janë paraparë. I licencuari ka paraparë vetëm shërbimet e mirëmbajtjes krahas trendit të rritjes së koston për njësi, të shprehur në MWh të energjisë së prodhuar.

ZRRE ka ndryshuar shumat e kërkuara, duke supozuar një kosto të standardizuar prej €0.92/MWh të energjisë së prodhuar, vlera e arritur gjatë vitit 2011. Prandaj, koston e mirëmbajtjes ndryshon në zvogëlim për €3.11 milionë.

3.2.5 Kostot e materialeve dhe furnizimeve

Kostot e materialeve dhe furnizimeve janë vlerësuar të jenë €4.85 milionë për periudhën 2013-2016 nga KEK-u. ZRRE beson se materialet dhe kostot e njësisë për furnizim duhet të jenë konstante në aspektin real, të shprehur si €/MWh. Duke qenë se kostoja për njësi është luhatur ndjeshëm në dy vitet që i kanë paraprirë periudhës rregullative, ZRRE ka aplikuar një vlerë mesatare për periudhën 2010-2011 e cila është barazi me €0.673 për MWh të energjisë së prodhuar elektrike.

3.2.6 Shpenzimet tjera operative

Nën “shpenzimet tjera operative” për Kosova A, KEK-u ka paraparë shpenzime në shumën e përgjithshme prej €11.4 milionëve në periudhën 2013-2016. Këtu përfshihet rialokimi i kostos së administratës qendrore, shpenzimet e sigurimit, licencat dhe shpenzimet “tjera”.

Lidhur me **alokimin e kostos për administratën qendrore**, këto janë alokuar, duke ndjekur të njëjtën qasje si tek të licencuarit tjetër.

Kostot e sigurimit janë kërkuar për tërë periudhën rregullative, dhe është barazuar me vlerën e paraparë për 2012.

Kostot e licencave

KEK ka paraparë një nivel të ndryshueshëm të kostos për të mbuluar “licencat” tjera. ZRRE-ja ka lejuar këto kosto.

Shpenzimet tjera janë ulur duke aplikuar vlerën mesatare për periudhën 2011-2012, gjegjësisht në €396,000 /vit.

Në përgjithësi, *shpenzimet tjera operative* janë ulur për €0.259 milionë më pak se shuma e kërkuar nga KEK-u në parashtresën e vet.

3.2.7 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për propozimet e shpenzimet operative të KEK-ut për TC Kosova A

Tabela në vijim përmbledh shpenzimet e përgjithshme operative për Kosova A të propozuar nga KEK-u për periudhën 2013 deri 2016, së bashku me vlerësimin përfundimtar të ZRRE-së për disa nga këto shpenzime. Duhet të ceket se tabela në vijim nuk përfshin koston interne të thëngjillit e cila paguhet nga Kosova A për Divizionin e Mihjes si dhe zhvleftësimin dhe amortizimin.

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

Tabela h – Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet operative të TC Kosova A

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për shpenzimet operative të TC Kosova A	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej € 000's
Sh. Operative të kërkuar nga KEK-u	19,604	20,029	20,300	20,349	80,281
Sh. Operative të lejuara nga ZRRE	17,569	16,590	15,735	14,893	64,786
Dallimi (€ 000's)	-2,035	-3,438	-4,565	-5,456	-15,495
Dallimi %	-10%	-17%	-22%	-27%	-19%

3.3 Kosova B – Capex-i i Propozuar

Projektet kapitale të planifikuara për Kosovën B në periudhë janë përshkruar në Shtojcën A, së bashku me një vlerësim teknik të arsyetimit të KEK-ut për projektet.

Përveç projekteve të planifikuara për periudhën e ardhshme të kontrollit, 2013-2016, parashtrësa e KEK-ut përmbante një numër të projekteve për vitin 2012, siç tregohet në Tabelën i.

Tabela i - Projektet kapitale të Kosovës B në zhvillim e sipër

Projektet e propozuara kapitale të KEK-ut për TC Kosova B	2012 €000s
Remonti Kapital Njësia B1	
Ndërprerësit për B1 dhe B2	
Disqet me shpejtësi të ndryshueshme për Njësitë B	
Rotorët për pompat e bojlerit për Njësitë B (4)	
Motorët elektrik për Njësitë B	
Puna e paparashikuar/paplanifikuar	
Gjithsej	27,570

Përveç kësaj, *tabela j* më poshtë tregon projektet kapitale për Kosova B të planifikuara nga KEK-u Divizioni i Gjenerimit për periudhën e tarifore, 2013-2016:

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

Tabela j – Kosova B Projektet Kapitale të Propozuara 2013-2016 nga KEK

Projektet për 2013-2016	2013 €000s	2014 €000s	2015 €000s	2016 €000s	Total €000s
TCB-2550 Rrethimi & portat e larta rrethuese					
Kamerat e vëzhgimit					
Kamioni i ri zjarrfikës					
Tjera (kullat ftohëse, oxhak, trajtimi kimik i ujerave)					
Kapsula mbeshjtjellëse e re e Turbinës me Presion të Lartë Njësia					
Remonti pesëvjeçar Njësia B1					
Remonti pesëvjeçar Njësia B2					
Modernizimi i sistemit të mulliri të thëngjillit dhe sistemit të					
Totali i shpenzimeve kapitale (të gjitha vitet)	11,572	7,500	22,000	15,000	56,072

3.3.1 TCB - 2550 Rrethimi (Përfshirë 4 portat rrethuese të larta)

Sikur me lokacionin e Kosova A, KEK-u gjithashtu propozon ngritjen e rrethojave, ku është e nevojshme për të ndarë dhe për të mbrojtur pronën e pasurive të patundshme të termocentralit Kosova B nga divizionet fqinje të thëngjillit. KEK-u ka dhënë detajet e specifikimit dhe arsytimit për këtë kosto, ZRRE-ja e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon të lejojë këtë kosto në mënyrë të plotë.

3.3.2 Kamerat e vëzhgimit

KEK-u propozon instalimin e kamerave të sigurisë të destinuara për të monitoruar objektin e termocentralit Kosova B, në intervale prej 60m në rrethojat e reja të sigurisë. ZRRE-ja e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon të lejojë këtë kosto në mënyrë të plotë.

3.3.3 Kamioni i ri zjarrfikës për Gjenerim

Si me Kosovën A, KEK-u ka ndërmend të blejë një kamion të ri zjarrfikës për Stacionin e Kosovës B me një shkallë prej 40m pasi pajisjet ekzistuese nuk mund të arrijnë lartësinë e mjaftueshme. ZRRE-ja e konsideron këtë të arsyeshme dhe propozon të lejojë këtë kosto në tërësi.

3.3.4 Hapja e bombolave të presionit të lartë dhe të tjera

Në versionin e fundit të pranuar të shablloneve ky artikull është zbërthyer në “Modernizimi i transmisionit të sistemit të mullinjve (16 mullinj)” dhe “KF, oxhaku, dhe tjera”, ZRRE ka kërkuar shpjegim nga KEK-u për natyrën e investimit. Është shpjeguar se investimi ka të bëjë me zëvendësimin e sistemit të makinës hidraulike me shpejtësi për secilin nga mullinjtë. KEK-u vlerëson koston bazuar në rregullin e përafrimit, dhe duke pasur parasysh se KEK-u nuk ka shkuar përmes procesit të tenderimit për këtë investim e poashtu duke pasur parasysh numrin e madh të artikujve që do të prokurohen nga i njëjti prodhues, ZRRE-ja e lejojë këtë kosto me 50% të shumës së kërkuar.

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

Artikulli tjetër, “KF, oxhaku, dhe tjera” i referohet renovimit të sistemeve të përbashkëta (kullat ftohëse, oxhak, trajtimit të ujërave kimike). Kjo shumë është konsideruar e arsyeshme, dhe ZRRE-ja propozoi që të lejojë këto investime.

3.3.5 Kapsula mbështjellëse e re për Turbinën me Presion të Lartë, Njësia B1

Shtresa e turbinës me presion të lartë për Njësine B1 është e plasaritur dhe funksionimi i saj në këtë gjendje konsiderohet i pasigurt. Turbina është një turbinë Alstom dhe shtresa duhet të projektohet dhe ndërtohet nga kompania e njëjtë. Koha e dërgesës është 12 muaj. Vlerësimi nga Alstomi është pranuar dhe ZRRE-ja propozon të lejojë këtë kosto.

3.3.6 Rinovimi Kapital, Njësia B1

KEK-u propozon kryerjen e renovimit 5 vjeçar të Njësive B2 (2015) dhe B1 (2016) gjatë periudhës së kontrollit të ardhshëm. Punimet do të përfshijnë renovimin e turbinave me avull të njësive, elektro-gjeneratorin dhe bojlerin. EIHP ka këshilluar që këtu përfshihen artikuj të cilët nuk janë të domosdoshëm. Prandaj ZRRE-ja ka reduktuar lejimin e KEK-ut për këto zëra kapital në 2 milion € për çdo remont.

3.3.7 Vlerësimi përfundimtar i Capex-it nga ZRRE për Kosovën B

Vlerësimi përfundimtar nga ZRRE për capex-in Kosova B është përcaktuar në tabelën k më poshtë.

Tabela k - Vlerësimi përfundimtar nga ZRRE për SH. Kapitale të TC Kosova B

Vlerësimi përfundimtar nga ZRRE për capex-in Kosova B	2012 € 000's	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Total € 000's
Capex i kërkuar i KEK-ut	27,570	11,572	7,500	22,000	15,000	83,642
Capex i propozuar i ZRRE-së	17,343	9,072	5,500	16,500	13,000	61,415
Dallimi (€ 000's)	-10,227	-2,500	-2,000	-5,500	-2,000	-22,227
Dallimi %	-37%	-22%	-27%	-25%	-13%	-27%

3.4 Opex i Propozuar i “TC Kosova B”

3.4.1 Rialokimi i kostove të administratës qendrore

ZRRE-ja ka rialokuar shpenzimet e administratës qendrore për Kosova B në të njëjtën mënyrë siç është përshkruar për Divizionin e Minierave në seksionin 3.2.1 më sipër.

3.4.2 Kostot e stafit

Si me Kosovën A dhe me aktivitete të tjera të licencuara, KEK-u ka supozuar një rritje prej 5% në shpenzimet e stafit mbi koston e inflacionit. ZRRE-ja konsideron se nuk ka justifikim për këtë rritje të shpenzimeve të stafit në terma real. Prandaj, propozon të

lejojë shpenzimet e pagave në nivelin real të 2012, për periudhën e kontrollit për Kosovën B.

3.4.3 Kostot e karburantit dhe shërbimet tjera

Shpenzimet e parashikuara të KEK-ut rreth 21.15 milion € gjatë periudhës 2013-2016 për "Kostot e karburantit dhe shërbimet tjera" për Kosovën B, një zë i koston i cili përbëhet nga: kosto e karburantit (pa koston e thëngjillit), koston e lubrifikantit dhe kimikaleve të tjera, si dhe kostot për ujë dhe gas.

Kostoja e karburantit, e cila i referohet koston së mazutit, është marrë si një shumëfish i koston së mazutit të parashikuar për njësi dhe sasisë së pritur të mazutit që do të përdoret. ZRRE ka shqyrtuar supozimin prapa këtyre vlerave dhe mendon se ato janë të arsyeshme.

3.4.4 Kostot e mirëmbajtjes

Ky zë përbëhet nga zërat e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes. Për periudhën tarifore, shërbimet e riparimit nuk janë paraparë. I Licencuari ka paraparë vetëm shërbime të mirëmbajtjes me trendin e koston për njësi në rënie, e shprehur për MWh të energjisë elektrike të gjeneruar. ZRRE-ja ka vlerësuar si të arsyeshme keto shpenzime dhe ka lejuar vlerat e kërkuara.

3.4.5 Shpenzimet tjera operative

Nën "shpenzime të tjera operative" për Kosovën B, KEK-u ka kosto totale të parashikuara prej 12.6 milion € në periudhën 2013-2016. Kjo përfshin rialokimin e shpenzimeve të adëministratës qëndrore, kostot e transportit, sigurisë, licencat dhe shpenzimet "tjera".

Sa i përket **alokimit të koston sëadëministratës qëndërore**, këto janëalokuar, duke ndjekur një qasje të njëjtë të përdorur për të licencuarit tjerë.

Kostot e Shërbimit të transportit, siç janë propozuar nga i licencuari, për vitet 2012-2016 janë lejuar në nivelin i vitit 2011, viti i vetëm historik për të cilin kjo kosto ka qenë e regjistruar.

Kostot e sigurisë kanë qenë të kërkuara në të njëjtin nivel si vitin e kaluar dhe janë të barabartë me vlerën e parashikuar për vitin 2012.

Kostot e licencës, ZRRE ka lejuar këto kosto.

Shpenzime të tjera janë rregulluar me një zbritje duke përdorur vlerën për 2012.

Në përgjithësi, shpenzimet tjera operative të rregulluara për Kosova B janë më të ulëta për 2.8 milion € se shuma e kërkuar nga KEK-u në parashtresën e tij.

3.4.6 Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për Shpenzimet operative të “TC Kosova B”

Tabela e mëposhtme përmbledh shpenzimet totale operative të propozuara nga KEK-u për Kosovën A për periudhën 2013-2016, së bashku me vlerësimin përfundimtar të ZRRE-së të atyre shpenzimeve. Duhet të theksohet se tabela më poshtë e përjashton koston e transferimit të brendshëm të thëngjillit dhe zhvlerësimin dhe amortizimin.

Tabela I – Vlerësimi përfundimtar i Sh. Operative “TC Kosova B”

Vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së për Sh. Operative të "TC Kosova B"	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Total € 000's
Sh. Operative të kërkuara nga KEK-ut	15,192	15,479	15,787	16,046	62,505
Sh. Operative të lejuara nga ZRRE	14,134	13,563	13,021	12,523	53,240
Dallimi (€ 000's)	-1,057	-1,917	-2,767	-3,524	-9,265
Dallimi %	-7%	-12%	-18%	-22%	-15%

4 Parametrat tjera rregullativë

4.1 Faktori i efikasitetit

Rregullin për përcaktimin e çmimeve, ZRRE obligohet të përcaktojë një faktor efikasiteti që do të aplikohet për kostot operative dhe të mirëmbajtjes. Një faktor i vetëm do të caktohet për të gjithë periudhën e TSHV-së në një nivel që pasqyron arritjet që mund të priten gjatë periudhës nga një operator efikas. Në përcaktimin e nivelit të faktorit të efikasitetit, ZRRE-ja ka konsideruar kostot e menaxhimit të biznesit nga Departamenti i Gjenerimit dhe të Minierave dhe ka marrë parasysh nivelin e produktivitetit në kompanitë ndërkombëtare krahasuese.

ZRRE-ja konstaton se ekziston mundësia për arritjet e mëdha të efikasitetit në aktivitetet e Gjenerimit dhe Minerareve, veçanërisht pasi kjo do të jetë hera e parë që një faktor i efikasitetit është aplikuar në kompanitë dhe përvoja tregon se kompanitë janë në gjendje të demonstrojnë arritjet më të larta të efikasitetit në fazat fillestare të rregullimit stimulues. ZRRE-ja konsideron se një vlerë prej 4% në vit është një faktor i përshtatshëm i efikasitetit në periudhën e TSHV-së, duke përfaqësuar kështu një stimulim sfidues për Gjenerim dhe Miniera që t'i zvogëlon shpenzimet e veta dhe për të arritur fitimet në qoftë se tejkalon këtë nivel të përmirësimit, ndërsa në të njëjtën kohë duke iu siguruar përfitime konsumatorëve nëpërmjet uljes së presionit mbi tarifat.

4.2 Mesataren e Ponderuar e Kostos së Kapitalit (MPKK)

ZRRE-ja ka vendosur Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit për Gjenerim bazuar në vlerësimet e mëparshme të kthimit të kërkuar në kapital, kosto aktuale e financimit të borxhit dhe nivelin aktual i gearing (norma borxh/ekuitet) (që i nënshtrohet kufizimeve përgatitjes të dhënë në diskutimet e mëparshme të ZRRE-së mbi MPKK.

Vlerësimi përfundimtar – Detajet për KEK Gjenerimin

ZRRE-ja fillimisht ka supozuar një kthim komercial në kapital për të gjitha kompanitë e rregulluara në sektor. ZRRE-ja më tej ka kërkuar udhëzime nga qeveria për sa i përket nivelit të kthimit në kapital që qeveria mund të kërkojë si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria ka bërë me dije se ata do të konsiderojnë një kthim më të ulët nga operatorët në pronësi publike në krahasim me një kthim që mund të pritët nga një pronar privat. Prandaj vlerësimi përfundimtar i ZRRE-së është se një nivel prej 5.50% i kthimit pas-tatimit në kapital është e përshtatshme për kompanitë në pronësi publike. Për këtë arsye ZRRE-ja ka përdorur këtë kthim në kapital në vlerësimin e MPKK-se për Gjenerim.

MPKK për Gjenerim është vendosur në 5.22% (reale, para-tatimit).

5 MAR përfundimtarë 2013-2016

Duke ndjekur vlerësimin e tij të kapitalit të KEK-ut dhe propozimeve të kostos operative, vlerësimet përfundimtare të përshkruara më sipër, dhe parametrat e propozuara rregullatore, ZRRE-ja ka llogaritur MAR-et për aktivitetet e licencuara të KEK-ut në përputhje me Rregullen e përcaktimit të çmimeve të Gjenerimit. Këto janë të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela m – Vlerësimi përfundimtar i MAR-eve për Gjenaroret e rregulluar të KEK-ut

Vlerësimi përfundimtar i MAR-it për KEK Gjenerimin	2013 € 000's	2014 € 000's	2015 € 000's	2016 € 000's	Gjithsej € 000's
"TC Kosova A" dhe "TC Kosova B"	150,957	151,584	152,776	152,697	608,014